



UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE  
УНИВЕРЗИТЕТ НА ЈУГОИСТОЧНА ЕВРОПА  
SOUTH EAST EUROPEAN UNIVERSITY

# RAPORTI I VETËVLERËSIMIT 2015/2016

---

UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE

Komisioni i vetëvlerësimit  
UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE

## PËRMBAJTJA

<b>Emri i institucionit dhe periudha e vlerësimit .....</b>	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
<b>Autorët e raportit dhe ata që janë konsultuar .....</b>	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
<b>Përshkrimi i institucionit .....</b>	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
Historiku dhe gjendja aktuale e institucionit .....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
Numri i stafit akademik dhe administrativ .....	7
Numri i studentëve .....	7
Numri i programeve studimore në ciklin e parë të studimeve .....	7
Forma të tjera të arsimit të vazhdueshëm .....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
Pozita e institucionit në kuadër të arsimit të lartë në nivel shtetëror dhe ndërkombëtar	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
<b>Misioni dhe qëllimet e institucionit .....</b>	<b>8</b>
Përshkrimi i qëllimeve të institucionit në lidhje me shkencën, komunitetin dhe punësimin .....	8
Përshkrimi i Misionit në lidhje me institucionet e tjera të arsimit të lartë në vend, rajon dhe nivel ndërkombëtar .....	11
Përshkrimi i metodave të përmirësimit të institucionit (të brendshme dhe të jashtme) .....	12
Përshkrimi i zhvillimit dhe procesit të krijimit të Planit strategjik .....	13
Përshkrimi i mekanizmave të përdorura për sigurimin e cilësisë në Institucion .....	14
Zyra e cilësisë organizon sesione trajnimi dy herë në vjet për të gjithë stafin, duke u bazuar mbi nevojën apo interesin e identifikuar ose të kërkuar. ....	14
<b>Njësitë akademike dhe oferta .....</b>	<b>15</b>
Përshkrimi i programeve të studimit .....	15
Përshkrimi i stafit me angazhim të plotë dhe të pjesshëm .....	17
Numri i përgjithshëm i të punësuarve për pesë vitet e fundit .....	17

Proporcioni studentë – mësimdhënës në programet studimore .....	18
Metodat e aplikuara në mësimdhënie .....	18
Shkalla e arritur e mësimdhënies nëpërmjet bashkëpunimit të jashtëm.....	20
Numri i përgjithshëm i orëve mësimore për mësimdhënësit (ose rregulloret që lidhen me ato).....	20
Zhvillimi profesional dhe trajnimi i stafit .....	21
Njohja e kontributeve të tjera nga safi për Universitetin, disiplinën dhe komunitetint.....	22
<b>Të dhëna për studentët .....</b>	<b>22</b>
Numri i studentëve të regjistruar në tre vitet e fundit .....	22
Numri i studentëve të diplomuar në tre vitet e fundit .....	22
Numri i studentëve nga një gjeneratë të cilët kanë diplomuar në kohë .....	23
Numri i studentëve të regjistruar në studimet e ciklit të II për pesë vitet e fundit .....	24
Numri i studentëve të regjistruar në studimet e ciklit të III.....	24
Numri i propozimeve tezave të doktoraturës të pranuar në pesë vitet e fundit.....	24
Numri i tezave të doktoraturës të mbrojtura në pesë vitet e fundit .....	25
Kalueshmëria e studentëve nga viti në vit.....	25
Përshkrimi i profileve të studentëve dhe numri i studentëve të përfshirë në vlerësimin e cilësisë.....	26
Llojet e aktiviteteve të studentëve .....	26
Pjesëmarrja e studentëve në qeverisjen e Universitetit.....	27
Të dhëna të përgjithshme për punësimin e studentëve/të diplomuarve .....	27
<b>Kapacitetet dhe burimet materiale .....</b>	<b>28</b>
Lloji i pajisjeve për mësimin teorik e praktik .....	28
Organizimi hapësinor i Universitetit .....	29
Disponueshmëria e internet dhe lidhshmëria e studentëve të Universitetit .....	30

Kompjuter janë lehtësisht në dispozicion në të dy kampuset dhe përdoren nga studentët.....	30
Bibliotekat dhe fondi i tyre .....	30
<b>Logjistika dhe shërbimet për studentët .....</b>	<b>31</b>
Përshkrim i sistemeve informative për informim të studentëve – brenda dhe jashtë.....	31
Struktura e shërbimeve studentore .....	32
Shërbimet e bibliotekës.....	33
<b>Bashkëpunimi i jashtëm.....</b>	<b>34</b>
Bashkëpunimi me industrinë, institucionet qeveritare, OJQ-të dhe shoqatat e tjera profesionale.....	34
Pjesëmarrja në programet evropiane në pesë vitet e fundit.....	35
Mobiliteti i studentëve dhe stafit .....	36
Dimensioni ndërkombëtar i programeve studimore .....	36
Kontaktet me Alumnin.....	38
<b>Aktiviteti i hulumtimeve shkencore .....</b>	<b>38</b>
Numri i publikimeve në pesë vitet e fundit .....	39
Pjesëmarrja në seminare, konferenca dhe asamble shkencore në pesë vitet e fundit .....	40
Numri i përgjithshëm i kuvendeve shkencore të organizuara në pesë vitet e fundit.....	40
Numri dhe përshkrimi i profesorëve vizitues shkencorë .....	41
Shpërblimet e fituara për veprimtarinë shkencore .....	41
<b>Financimi .....</b>	<b>41</b>
Mënyra e realizimit të financimit .....	41
Përqindja e pagesës së shkollimit të studentëve në asetet e përgjithshme.....	42
Pagesa e shkollimit .....	42
<b>Përfudnimi dhe rekomandimet për pjesën institucionale .....</b>	<b>42</b>

Përfundimi .....	42
Rekomandimet për përmirësim.....	43

## EMRI I INSTITUCIONIT DHE PERIUDHA E RISHIKIMIT

Ky raport është Raporti i vetëvlerësimit i Universitetit të Evropës Juglindore. Ai mbulon periudhën nga 1 shtatori 2015 deri më 31 gusht 2016. Është menduar të reflektojë edhe mbi tri vitet e mëparshme akademike, në mënyrë që të sigurojë informata të dobishme për përpilimin e Planit të ri strategjik të Universitetit, për të zëvendësuar Planin strategjik 2013-2016.

## AUTORËT E RAPORTIT DHA ATA QË JANË KONSULTUAR

Ky raport ka për autor ekipin e konstituar në Senatin e Universitetit të Evropës Juglindore, të njohur si Komisioni i vetëvlerësimit. Ai përfshin përfaqësues të menaxhmentit të Universitetit, fakulteteve dhe të administratës, si: Provosti, Sekretari i përgjithshëm, prorektori për ndërmarrësi dhe planifikim, këshilltarja ekzekutive për cilësi, drejtori i kampusit në Shkup, drejtori i Shërbimeve studentore, përgjegjësi i Qendrës së karrierës, përfaqësues të të gjitha pesë fakulteteve, drejtori i Qendrës së gjuhëve, drejtori i Qendrës e-Learning, përfaqësues nga Parlamenti i studentëve dhe asistentja për sigurimin e cilësisë si mbështetje teknike. Komisioni gjithashtu falënderon për kontributin e tyre për Raportin edhe Alajdin Demirin, Fikret Shabanin, Bujar Sinanin, Nebi Xhemalin, Zeqirja Tairin, Albulena Halilin, Kreshnik Mustafain, Fëllënza Abdiun, Burim Ismailin, dhe Emsale Murtezanin për informatat në lidhje me të dhënat e studentëve, financimin dhe programet akademike.

Ky raport ka për qëllim të ofrojë një pasqyrë gjithëpërfshirëse të situatës aktuale të Universitetit, përmes të dhënave të veçanta, analizës së mundësive dhe vështirësive dhe një diskutim të sigurt të zhvillimeve aktuale që ndikojnë në Universitet.

Duhet të theksohet se ky raport ndjek një format të ndryshëm nga Raportet e Vetëvlerësimit të Universitetit të viteve të mëparshme. Në vitet e mëparshme, ky raport ka ndjekur një format standard dhe konsistent, në mënyrë që të ndihmojë leximin e krahasueshëm. Ky raport, megjithatë, ndjek modelin e përgjithshëm të sugjeruar për vlerësimin e jashtëm të universitetit nga ana e Ministrisë së Arsimit të Republikës së Maqedonisë. Ky raport është i tillë për shkak se ky vit përkon me përpilimin e Planit të ri strategjik të Universitetit nga ana e Bordit dhe u vlerësua nga Komisioni i Vetëvlerësimit dhe Ekipi ekzekutiv i Rektorit se formati template i Ministrisë do të sigurojë një format të dobishëm për prezantimin e të dhënave përkatëse.

Për shkak të kësaj, disa elemente të raporteve të mëparshme nuk janë riprodhuar këtu dhe elementeve të tjera u është kushtuar një kujdes më i thellë se në raportet e mëparshme. Është parashikuar se formati "tradicional" i Raportit të Vetëvlerësimit do të përdoret përsëri në dy vitet e ardhshme dhe se ky format i ri do të përdoret në vitin e tretë për të ndihmuar Bordin në krijimin e planeve të ardhshme strategjike.

Është mendimi i Komisionit të vetëvlerësimit, që ka përdorur këtë formularë template, se ky format i raportit fokusohet me shume mbi të dhëna të fiksuara se sa në trendet e përgjithshme në analizën e të dhënave.

## PËRSHKRIMI I INSTITUCIONIT

## HISTORIA DHE SITUATA AKTUALE E INSTITUCIONIT

Universiteti i Evropës Juglindore është hapur në vitin 2001, me mbështetjen e fuqishme të bashkësisë ndërkombëtare. Ishte dhe mbetet i përkushtuar për të ofruar një arsimim të veçantë shumetnik, shumë-gjuhësor dhe shumëkulturor në Republikën e Maqedonisë dhe rajonin më të gjerë, duke u bazuar mbi tendencat kryesore të arsimit të lartë ndërkombëtar. Është një institucion bashkarsimor dhe pranon studentët e të gjitha etnive, gjinive, gjuhëve, përkatësive fetare dhe besimeve politike, në bazë të meritës dhe aftësisë.

Është një Universitet që ofron kualifikime në pesë fakultete, në të tre ciklet e arsimit të lartë, deridiplomike, pasdiplomike dhe studimet e doktoratës. Pesë fakultetet e UEJL-së janë: Fakulteti i biznesit dhe ekonomisë; Fakulteti i shkencave dhe teknologjive bashkëkohore; Fakulteti i gjuhëve, kulturave dhe komunikimit; Fakulteti i drejtësisë; dhe Fakulteti i administrimit publik dhe shkencave politike.

Universiteti ka një kategorizim të veçantë ligjor: është institucion publik, privat, jofitimprurës, duke qenë i dallueshëm nga të dy llojet e institucioneve private dhe nga universitetet publike plotësisht shtetërore.

Që nga hapja në vitin 2001, Universiteti i Evropës Juglindore ka parë një transformim të rëndësishëm në rrethanat në të cilat operon. Legalizimi i mësimimit në gjuhën shqipe për arsimin e lartë ishte një zhvillim i rëndësishëm që ka të ngjarë të jetë inkurajuar nga ekzistenca e UEJL-së. UEJL është zgjeruar edhe nga kampusi i tij origjinal Tetovë ka hapur një kampus në kryeqytetin e Shkupit: Kampusi i parë në Shkup ishte i vogël dhe i përshtatur, ndërsa ndërtesa e tanishme është një vend qëllimisht – i modifikuar në zemër të qytetit, me një vend simbolik në një urë lidhëse në mes pjesës së vjetër dhe pjesës së re të qytetit.

Jo të gjitha zhvillimet, megjithatë, kanë qenë të dobishme. Që nga hapja zyrtare e Universitetit, ekonomia botërore ka pësuar një rënie të zgjatur, duke shkaktuar vështirësi të mëdha të financimit, si në aspektin individual (familjet kanë më pak para) dhe kushtet institucionale (ka më shumë institucione të konkurrojnë për projekte dhe grante). Në mënyrë të ngjashme, realitetet demografike kanë bërë që të ketë një numër të reduktuar të studentëve potencialë të cilët Universiteti mund t'i rekrutojë. Së fundi, duhet theksuar se aktualisht në Republikën e Maqedonisë vepron një numër i institucioneve arsimore që nuk ekzistonin kur u themelua UEJL. Disa nga këto janë, ose kanë për qëllim që të jenë, plotësisht publike dhe për të nxjerrë të ardhurat e tyre kryesore nga subvencionet qeveritare .

Kështu Universiteti i Evropës Juglindore përballet me një të ardhme të vështirë, por gjithashtu është mirë i përgatitur për të përmbushur këto sfida. Ka burime njerëzore të reputacionit rajonal dhe të cilët kanë një përkushtim të lartë ndaj institucionit dhe misionit; kampuset janë në dy vende të lakmueshme; ka mekanizma të fortë të sigurimit të cilësisë dhe mbështetje të mësimdhënësve dhe ka prestigj kombëtar e reputacionin për cilësinë mësimdhënies dhe e arrijten e studentëve. Megjithatë gjithashtu përballet me konkurrencën në rritje;

rekrutimin më të vështirë e më pak studentë dhe nevojën për të konkurruar financiarisht me institucionet që mund t'ia dalin të marrin ndihmën më të madhe të të ardhurave të tyre nga subvencionet e shtetit, dhe që për këtë arsye janë në gjendje të ofrojnë tarifa jashtëzakonisht të ulëta për shkollim për studentët. Gjithashtu përballet me konkurrencën në rritje; rekrutimin më të vështirë e me numrin më të vogël të studentëve; me nevojën për të konkurruar financiarisht me institucionet të cilat mund t'ia dalin që pjesën më të madhe të të ardhurave të tyre ta kenë nga ndihma e shtetit, dhe që për këtë arsye janë në gjendje të ofrojnë tarifa jashtëzakonisht të ulëta për shkollim për studentët.

#### NUMRI I STAFIT AKADEMIK DHE ADMINISTRATIV

Deri në datën e përmbylljes së këtij raporti, janë 278 punonjës të Universitetit të Evropës Juglindore. Ata janë të shpërndarë si më poshtë. Ka 158 anëtarë të stafit akademik, 108 prej tyre janë të punësuar me kohë të plotë, ndërsa 50 të tjerë janë të punësuar me kohë të pjesshme. Janë 120 staf administrativ, prej të cilëve 113 janë të punësuar me kohë të plotë, dhe 7 janë të punësuar me kohë të pjesshme.

#### NUMRI I STUDENTËVE

Numri i përgjithshëm i studentëve aktivë është 2540. Kjo mbulon të tri ciklet dhe të gjitha fakultetet. Kjo është shpërndarja e mëposhtme: 1867 studentë në ciklin e parë; 630 studentë në ciklin e dytë; dhe 43 studentët të doktoratës.

#### NUMRI PROGRAMEVE STUDIMORE NË CIKLIN E PARË

Numri i programeve studimore në ciklin e parë të studimeve aktualisht është 11 programe.

*Numri i programeve studimore në ciklin e dytë të studimeve*

Numri i programeve studimore në ciklin e dytë të studimeve aktualisht është 30 programe.

*Numri i programeve studimore në ciklin e tretë të studimeve*

Numri i programeve të studimore në ciklin e tretë të studimeve aktualisht është 12 programe.

#### FORMA TË TJERA PROGRAMESH TË EDUKIMIT TË VAZHDUESHËM

Universiteti i Evropës Juglindore nuk bën dallim mes studentëve sipas moshave; prandaj është e mundur që të ketë njerëz me mosha dhe me përvoja të jetës në mënyrë të konsiderueshme të ndryshme në një klasë të vetme. Ky është një fenomen veçanërisht e haset në ciklin e dytë dhe të tretë të studimeve.



Në disa programe, Universiteti ka ofruar mundësinë "+1" vit studimi për ata të diplomuarit e programeve tona 3-vjeçare që e shohin të arsyeshme të marrin një vit shtesë dhe kështu dalin me një diplomë B.A. prej 240 ECTS kredive. Kjo mënyrë është dëshmuar gjerësisht e preferuar me studentët të cilët ishin të paafte për të gjetur punë pas diplomimit në studimet tre-vjeçare, ose ata të interesuar në ndjekjen e punës në tregjet ku një diplomë katërvjeçare është e dëshirueshme (si në Amerikën e Veriut).

Veçanërisht në lidhje me arsimim e vazhdueshëm, UEJL ofron studime me korrespondencë, kryesisht përmes të studiuarit në distancë mundësuar nga *Sistemit të menaxhimit të të mësuarit* (Learning Management System) që ofrohet nga Universiteti dhe *Google Classroom*. Gjithashtu Universiteti ofron trajnime dhe udhëzime të veçanta nëpërmjet Qendrës për zhvillimin e biznesit, ashtu siç kërkohet nga subjektet e jashtme dhe që kanë rënë në pajtim me Universitetin.

## POZITA E INSTITUCIONIT NË KUADËR TË ARSIMIT TË LARTË NË NIVEL SHTETËROR DHE NDËRKOMBËTAR

Universiteti i Evropës Juglindore ka qenë dy herë i ranguar nga Shanghai Jiao-Tong University proces ky i mandatuar nga shteti. Në herën e parë, UEJL u vlerësua në pozitën dytë në pozitë në nivel shtetëror dhe herën e dytë Universiteti u radhit i treti në nivel shtetëror. Këto janë rezultate të larta duke pasur parasysh procesin i cili disa herë është shoqëruar nga fshehtësia e procedurave të aplikuara dhe metodologjia e të dhënave të gjeneruara. Në të dyja rangimet, UEJL ishte institucioni i arsimit të lartë joshtetëror më i lartë i ranguar, me ofertë specifike akademike në gjuhë shqipe. Rezultatet nga rangimi i tretë priten të dalin së shpejti, por nuk ishin në dispozicion gjatë kohës së përpilimit të këtij raporti.

UEJL, që nga themelimi i tij, ka modeluar veten sipas institucioneve ndërkombëtare dhe në veçanti në vitet e mëparshme fillestare ka qenë i ndihmuar nga Universiteti i Indianës. Në kushtet e arsimit bashkëkohor të lartë ndërkombëtar, UEJL ka partneritet.

Programet akademike të UEJL-së janë modeluar sipas kurrikulave ndërkombëtare dhe janë testuar nga Ekipet e cilësisë të cilët takohet me palët e interesuara të brendshme dhe të jashtme për t'u siguruar se mësimdhënia dhe mësimi i demonstruar janë të përshtatshme me kriteret ndërkombëtare.

## MISIONI DHE QËLLIMET E INSTITUCIONIT

### DESCRIPTION OF THE AIMS OF THE INSTITUTION IN RELATION TO SCIENCE, COMMUNITY AND EMPLOYMENT

UEJL gjithmonë ka pasur për qëllim që të marrë pjesë drejtpërsëdrejti në komunitetin që i shërben. Këtë e ka bërë me sukses për një dekadë e gjysmë të ekzistencës së tij, në veçanti nga momenti i ofrimit të gjuhës shqipe në ofertën universitare në rajonin e Tetovës/Gostivarit që ishte rajoni i parë i shërbimit. Që nga zgjerimi në

Shkup, si dhe vendndodhja në kryeqytet ka shërbyer si një funksion simbolik për të shprehur misionin e bashkimit të etnive të ndryshme në Maqedoni përmes edukimit, gjithashtu duke siguruar qasje praktike në një ndërtesë të mirë në qendër të qytetit. UEJL mbetet modeli i shquar për arsimin e lartë shumëkulturore, shumëgjuhësor dhe shumetnik në Republikën e Maqedonisë.

Universiteti synon tani t'i shërbejë një shoqërie më të madhe, si në aspektin kombëtar, ashtu edhe të krijojë kushte për shërbime studentore ndërkombëtare. Rekrutimi i studentëve - sidomos në ciklin e dytë dhe të tretë të studimeve, ka qenë veçanërisht i fortë nga vendet fqinje, veçanërisht në Kosovë. Kështu, për shembull, në vitin akademik mbuluar nga ky raport (2015-2016), numri më i lartë i aplikantëve në UEJL ka ardhur nga Republika e Maqedonisë, me 1065 aplikime (76,90%); numri i dytë më i madh i aplikantëve ka ardhur nga Republika e Kosovës, me 259 aplikime (18.70%); dhe numri i tretë më i madh i aplikantëve ka ardhur nga Republika e Serbisë, me 21 aplikime (1.52%). Në atë vit, kishte aplikantë nga një total prej gjashtëmbëdhjetë vendeve të ndryshme, të përhapur nga Norvegjia, Jordania dhe Shtetet e Bashkuara. Prandaj, përpjekja kryesore për rekrutim qëndron në Republikën e Maqedonisë dhe në vendet fqinje, por ka edhe vend për rritje për rekrutimin e studentëve të diasporës. (Popullariteti në rritje i lëndëve që ofrohen në gjuhën angleze këtu mund të jetë një mjet i dobishëm rekrutimi për popullsinë e diasporës dhe kostoja relativisht e vogël e arsimit në UEJL për një arsim universitar amerikan ose britanik mund të jetë tërheqëse.)

Përveç misionit të tij kryesor të ofrimit të arsimit, UEJL gjithashtu kontribuon drejtpërdrejt në komunitet në mënyra të ndryshme. Të gjithë studentët tanë marrin pjesë në programet e detyrueshme "të punës praktike", të cilat i çojnë studentët në bizneset dhe institucionet në nivel vendi. Instituti i mjedisit jetësor dhe shëndetit ka ndihmuar komunën e Tetovës në krijimin e një Plan veprimi klimaterik për të përmirësuar mjedisin e Tetovës; UEJL ka marrë edhe kryesimin në energjinë e qëndrueshme dhe ndërtimin e një impianti të madh të paneleve diellore në kampusin e Tetovës. Stafi mësimdhënës ka vizituar shkollat rajonale dhe ka mbajtur gara, dhe seminare trajnuese për mësuesit e shkollave të mesme lokale.

Punësimi është një faktor vendimtar për çdo universitet dhe UEJL bën përpjekje serioze për të përafuar kurrikulën e tij me nevojat e tregut. Për këtë arsye, siç u përmend më parë në këtë seksion, Ekipet e cilësisë së fakulteteve takohen për të diskutuar reformën e kurrikulumeve me palët interesuara nga jashtë.

Përveç kësaj, Universiteti drejton Qendrën e parë të karrierës së themeluar në një institucion të arsimit të lartë në Maqedoni. Çdo vit Qendra e karrierës ofron ndihmë për punën praktike; trajnime të shkathtësive për punë (shkrim të c.v., kurse profesionale komunikimi, sjellja e duhur gjatë aplikimit në punë, etj.); Qendra e karrierës realizon anketë për punësimin e të diplomuarve të kohëve të fundit. Në anketën e fundit, shkalla e punësimit të të diplomuarve nga studimet deridiplomike ishte 44%, me 30% papunësi; më tej 11% janë deklaruar se i vazhdojnë studimet për arsye se nuk janë punësuar, kurse 10% janë deklaruar se i vazhdojnë studimet me vetëdëshirë; kurse pjesa e mbetur (5%) janë deklaruar se nuk janë punësuar me përcaktimin e tyre. Nga të punësuarit, 83% janë deklaruar se janë të punësuar me orar të plotë; 7% me orar të pjesshëm; 8% janë vetëpunësuar dhe 2% marrin pjesë në një program të punës praktike.




Figure 7: Unemployment Reason \* Pursuing Maste Studies

Papunësia është më e larta në mesin e të diplomuarve në Fakultetin e administrimit publik dhe Shkencat politike, me 63%. Kjo pasohet nga të diplomuarit e Fakultetit të drejtësisë me 50% papunësi; dhe pas tyre janë të diplomuar në Fakultetin e biznesit dhe ekonomisë me 42%. Të diplomuarit e Fakultetit të shkencave dhe teknologjive bashkëkohore kanë një normë papunësie prej 38%, ndërsa shkalla më e ulët e papunësisë në mesin e të diplomuarve të universitetit është në mesin e të diplomuarave të Fakultetit të gjuhëve, kulturave dhe komunikimeve, e cila ka një papunësi në normë 34%. Në rastin e të anketuarve sipas gjinisë, të anketuarit femra kanë raportuar papunësinë më të lartë (50%) sesa meshkujt (46%), edhe pse të anketuarit femra janë më të prirë të raportojnë të jenë të papunë me përcaktim personal. Të diplomuarit me prejardhje etnike shqiptare kanë raportuar një normë papunësie prej 53%, ndërsa të diplomuarit me prejardhje etnike maqedonase kanë raportuar papunësisë prej 31%; prej etnive tjera kanë raportuar 50% papunësi. Inkurajues është fakti se ata që kanë arritur notë mesatare më të lartë kanë raportuar shkallë më të lartë të punësimit, ata me notë mesatare mes 6-7 kishte një normë punësimi prej 50%, ndërsa ato me notë mesatare midis 9-10 kanë raportuar një shkallë punësimi prej 73%.

Në lidhje me kontributin e institucionit në fushat në të cilat operon, UEJL ka i përfshirë hulumtimin shkencor dhe kontributin shkencor në proceset promovuese dhe të punësimit të stafit. I gjithë stafi akademik tani është me kontratat ku kërkohet që ata të arrijnë sasi minimale të 'pikave' (përgjithësisht të barabartë me një konferencë apo punim shkencor, ose një publikim në revistë ndërkombëtare një herë në vit dhe publikim në revistë me ndikim në dy vjet). Në mënyrë të ngjashme, hulumtimi i botuar është kërkesë formale për promovimin e titullit akademik dhe rritja e produktivitetit ose ndikimit është e nevojshme për tituj më të lartë akademikë. Stafi është inkurajuar të marrë pjesë në konferenca dhe kongrese ndërkombëtare dhe për dy vitet e fundit (duke përfshirë vitin akademik që mbulohet nga ky raport), çdo anëtar i stafit akademik ka pasur mundësi për qasje në një fond prej 700 eurosh për mbështetje për hulumtim, tarifën e botimit, apo pjesëmarrjes në konferencë. Informacion shtesë mbi aktivitetet hulumtuese të stafit akademik do të gjenden në seksionin e titulluar 'veprimtaria hulumtuese - shkencore.'

Në lidhje me promovimin e shkencës në klasë, UEJL ka për qëllim të sigurojë mësimdhënie të përditësuar që merr parasysh zhvillimet më të fundit dhe të aplikueshme në fushat e mbuluara nga kurrikulat e tij. Në

përputhje me rrethanat, siç u përmend më parë, ofertat kurrikulare rishikohen periodikisht, si nga dekanët dhe zyrtarët e tyre, ashtu edhe nga ekipet e cilësisë në çdo fakultet (përfshirë edhe palët e interesuara të jashtme) dhe anketat me të diplomuarit që administrohen nga Qendra e karrierës kur kërkohet informatë kthyesë për shkathhtësitë e veçanta të cilat ishin të dobishme në vendin e punës, çfarë është e nevojshme në kurrikulë dhe çfarë nuk është të nevojshme. Përveç kësaj, mentorët e kandidatëve të magjistraturës dhe doktoratës janë të inkurajuar për t'i përfshirë studentët e tyre në hulumtim, aty ku është e arsyeshme dhe e përshtatshme, siç janë, bie fjala, publikimi i punimeve të përbashkëta dhe prezantimi i përbashkët i punimeve në kongrese akademike. Një punë e tillë bashkëpunuese, sigurisht, thjesht është në baza vullnetare nga ana e studentit, për të parandaluar mentorin për të 'përvetësuar' punimin e shkruar në radhë të parë nga vetë studentit; vetëm bashkëpunimi i vërtetë dhe i provueshëm inkurajohet.

Për arsye se Universiteti priret drejt shkencave sociale, ka pak nevojë për përmirësimin e vazhdueshëm të laboratorëve dhe burimeve fizike, siç hasen shpesh në institucionet që kanë laboratorët mjekësorë, kimikë, fizikë, inxhinierikë, apo astronomikë. Fenomeni i përmirësimit të vazhdueshëm në mënyrë që të mbajë ritmin me fushën haset pothuajse ekskluzivisht në shkencat dhe teknologjitë bashkëkohore.

#### PËRSHKRIMI I MISIONIT NË LIDHJE ME INSTITUCIONET E TJERA TË ARSIMIT TË LARTË NË VEND, RAJON DHE NIVEL NDËRKOMBËTAR

Universiteti i Evropës Juglindore është i vetmi universitet publik - private, jofitimprurës në Republikën e Maqedonisë. Kjo do të thotë se ka të drejtë për mbështetje dhe subvencion nga shteti, por kryesisht financohet nga pagesa e shkollimit dhe përpjekjet e tjera financiare dhe është institucioni jofitimprurës. Kjo e bën atë unik në mesin e sistemit universitar shtetëror dhe kolegjet private në Maqedoni.

UEJL gjithmonë ka konsideruar në misionin e tij si primar angazhimin për të siguruar arsim cilësor ndërkombëtar për studentët e Maqedonisë dhe të rajonit në gjuhën shqipe, maqedonase dhe angleze si dhe për t'i pranuar studentë, pavarësisht përkatësisë racore, etnike, fetare, gjinore, gjuhën e tyre amtare, bindjet politike apo anëtarësimit në parti. Universiteti ka për qëllim të prodhojë arsim cilësor e njëkohësisht t[ b]jë promovimin e komunikimit dhe mirëkuptimit ndërkulturor. Ky institucion arsimor ka reputacion rajonal për sukseset e arritura në këtë përpjekje, siç dëshmohet edhe nga shumëllojshmëria e gjerë e aplikacioneve të pranuar nga i gjithë rajoni për të studiuar në UEJL.

Universiteti, ndërkaq, e konsideron veten si një institucion partner të institucioneve të tjera të arsimit të lartë në Republikën e Maqedonisë dhe ka ndërtuar marrëdhënie kolegiale me institucionet shtetërore dhe institucione të tjera arsimore private. Kështu, për shembull, në qershor të vitit 2016, UEJL organizoi një seminar nacional të cilësisë, duke përfshirë këtu anëtarë të ftuar të universiteteve të tjera të shumta dhe kolegje dhe pjesëmarrës të tjerë të jashtëm; ky seminar ka prodhuar një komunikatë, duke u bazuar në sugjerimet kolektive të trupit të mbledhur dhe është shpërndarë për pjesëmarrësit dhe profesionistët e interesuar në të gjithë Republikën e Maqedonisë. Kjo ofron vetëm një shembull të mënyrës në të cilën UEJL

synon të promovojë kolegjalitetin duke ushtruar udhëheqjen tonë edukative institucionale për zhvillimin dhe ndikimin kolektive.

UEJL dëshiron që praninë ndërkombëtare ta mbështesë në marrëveshjet paraprake të bashkëpunimit. Universiteti u mbështet fillimisht nga Universiteti i Indianës, i cili ka dhënë këshilla të vlefshme dhe bashkëpunim cilësor. IU është ende një partner i vlefshëm i UEJL-së, dhe në dy vitet e fundit tre anëtarë të ndryshëm të stafit të IU kanë shërbyer në UEJL si reviewers të fakultetit të jashtëm, për të ndihmuar Universitetin për të ripërtërirë dhe për të përmirësuar kurrikulat tona me ekspertizë ndërkombëtare.

Duhet të theksohet se UEJL tashmë ka një reputacion të fortë rajonal edhe pse duhet pranuar, ende pa themeluar një rëndësi të konsiderueshme të përgjithshme jashtë korridorit Maqedoni-Shqipëri-Kosovë-Bosnjë-Serbi. UEJL duhet të sfidojë veten për të ndërtuar partneritete dhe bashkëpunime jashtë rajonit të përgjithshëm të Ballkanit, në mënyrë më të mirë për të zhvilluar kapacitetin tonë institucional dhe për të siguruar studentët dhe mësuesit tanë me përvojë më të madhe të jashtme dhe të ekspozimit. Për fat të keq, duhet pranuar se burimi kryesor i kontakteve ndërkombëtare mbeten njohjet individuale, që reduktojnë aftësinë tonë institucionale për të formuar marrëveshje të dobishme dhe produktive bashkëpunuese. Kontaktet duhet të jenë një detyrë e Universitetit për të ndërtuar, në të ardhmen e afërt, një plan më efektiv dhe gjithëpërfshirës për zhvillimin dhe mirëmbajtjen e marrëveshjeve praktike, të dobishme dhe të zbatueshme ndërkombëtare bashkëpunuese dhe shkëmbimin e studentëve dhe stafit.

UEJL ka pasur një ndikim të pamohueshëm në rajon; ka kontribuar dhe ka ndryshuar jetën. Deri më sot, ka pasur 19,839 studentë individualë të regjistruar në Universitetin dhe 10,290 diploma të veçanta të lëshuara. Për një institucion të ri, kjo është një arritje e rëndësishme dhe i njëjti duhet të ruhet, mirëmbahet dhe të avancohet.

#### PËRSHKRIMI I METODAVE TË PËRMIRËSIMIT TË INSTITUCIONIT (TË BRENDSHME DHE TË JASHTME)

Universiteti i Evropës Juglindore është një lider rajonal në sigurimin e brendshëm të cilësisë dhe përmirësimit institucional. Metodave të brendshme të përmirësimit janë të lidhura kryesisht me programet dhe sistemet e administruara nga Zyra e cilësisë, të cilat janë të detajuara në një seksion të veçantë, më poshtë.

Jashtë masave të brendshme specifike të mbikëqyrura nga Zyra e cilësisë, ka mekanizma të tjerë për Universitetin e vetë përmirësimit. Çdo fakultet drejton punën e mbledhjeve të Këshillit fakultetit, në të cilat vendimet dhe zhvillimet e rëndësishme janë diskutuar në një forum të hapur ku në përgjithësi zbatohet etikë dhe profesionalizëm. Kjo mundëson që i gjithë stafi mësues me tituj akademikë të marrë pjesë dhe t'i komentojë zhvillimet në Universitet. Universiteti gjithashtu merr vendime të rëndësishme në takimet e Këshillit të Rektorit dhe Senatit të Universitetit, që do të thotë se të gjitha ndryshimet e rëndësishme apo

propozimet duhet të përmbushin miratimin e përgjithshëm, dhe nuk mund të bëhet në mënyrë individuale nga kushdo pa mbikëqyrje të përgjithshme institucionale.

Ekziston edhe një sistem i "kutive për komente" të cilat vihen rreth e rrotull në kampus çdo vit, por ato nuk prodhojnë pothuajse asgjë substanciale (vitin e kaluar të kishte vetëm dy komente cinike për to).

Sistemet e jashtme të përmirësimit janë gjithashtu në dispozicion në Universitet. Një nga më të rëndësishmit është, siç u përmend, vizita dhe raportet e kampionëve cilësisë. Përveç kësaj, megjithatë, Universiteti (në baza tre-vjeçar) sjell profesionit për shqyrtimit të jashtëm individual të fakulteteve, në mënyrë për të komentuar në thellësi mbi kurrikulën, stafin, dhe arritjet e studentëve të fakulteteve. Kjo siguron komentim të jashtëm dhe ndërkombëtar mbi punën tonë dhe na mundëson për të mbajtur ritmin me ndryshimin e mjedisit arsimor në çdo fushë të ekspertizës. Në serinë më të fundit të vizitave, tre fakultetet (Biznesit dhe Ekonomisë, Shkencave dhe Teknologjive Bashkëkohore, dhe Gjuhët, Kulturat dhe Komunikimi) pritë ekspertë nga Universiteti i Indianës; Fakulteti i administrimit publik dhe Shkencave politike organizoi një ekspert nga Universiteti i Lubjanës; dhe Fakulteti i drejtësisë priti dy ekspertë nga Universiteti i Zagrebit.

Universiteti, gjithashtu, u përmbahet masave të jashtme të kontrollit të cilësisë dhe asociacioneve. Universiteti vazhdon të aplikojë për të marrë certifikimin ISO dhe është miratuar edhe iniciativa e hulumtimit të Universitetit për certifikim Euraxess HRS4R. Të dyja këto iniciativa kërkojnë pajtueshmëri me standardet dhe politikat e jashtme dhe do të diskutohen në pjesët e mëvonshme të këtij raporti.

#### PËRSHKRIMI I ZHVILLIMIT DHE PROCESIT TË KRIJIMIT TË PLANIT STRATEGJIK

Plani strategjik i Universiteti përpilohet nga Bordi i Universitetit, në konsultim me përditshmërinë e stafit dhe drejtuesit e Universitetit, fakulteteve dhe qendrave dhe menaxhmentin ekzekutiv të Universitetit. Plani strategjik përpilohet në bazë të tre vjeçare. Ky RVV është pjesë e kësaj përpjekje; sepse Bordi i Universitetit do të shkruajë një Plan të ri strategjik në fund të vitit 2016 (për të zëvendësuar Planin operativ strategjik 2013-2016), ky raport është autorizuar t'i sigurojë Bordit një RVV më të gjerë se është dorëzuar zakonisht.

Plani strategjik është një përpilim kolektiv i Bordit të Universitetit, edhe pse në përgjithësi anëtarët e Komitetit Ekzekutiv kanë rolin udhëheqës. Ata analizojnë provat e dhëna në dokumentacionin e Universitet, mundësitë e jashtme dhe të brendshme dhe kërcënimet, dhe formulimin e një politike për zhvillimin e institucionit. Pastaj kjo i paraqitet stafit të Universitetit dhe nëpërmjet ueb faqes së Universitetit shpallet edhe për publikun e gjerë.

Duhet theksuar se periudha trevjeçare praktike për shkak të ndryshimeve të paparashikueshme dhe nganjëherë të menjëhershme në Ligjin për Arsimin e Lartë RM bënë që planifikimi afatgjatë të jetë jashtëzakonisht i pasaktë.

Zbatimi i planit strategjik kryesisht i lihet menaxhmentit të Universitetit dhe fakulteteve edhe pse në praktikë është një proces i mbikëqyrur edhe nga raportet periodike mbi çështjet e veçanta të Bordit të Universitetit.

#### PËRSHKRIMI I MEKANIZMAVE TË PËRDORURA PËR SIGURIMIN E CILËSISË NË INSTITUCION

Universiteti udhëheq Zyrën për sigurimin e cilësisë dhe Këshilltarja ekzekutive është anëtare e Ekipit ekzekutiv të Rektorit. Kjo zyrë drejton një numër mekanizmesh të rëndësishme të sigurimit të cilësisë dhe përmirësimit institucional, e cila do të detajohet më poshtë.

I gjithë stafi mësimdhënies vëzhgohet rregullisht nga kolegët. Në fillim i gjithë stafi akademik vëzhgohej një herë në vit, por, për arsye logjistike, në periudhën e mbuluar nga ky raport, kjo u reduktua në një herë në dy vjet. Në këtë proces, anëtari i stafit akademik informohet se ai apo ora mësimore e tij do të vëzhgohet dhe nga një ekip prej dy vëzhguesve të cilët do ta përcjellin atë orë. Ata pastaj sigurojnë informatë kthyesë mbështetëse dhe përpilojnë një raport, që më pas diskutohet me anëtarin e stafit i cili ka qenë i vëzhguar dhe që (si pjesë e këtij raporti) mund të regjistrojë ndonjë kundërshtim apo sugjerim për raportin. Këto raporte vihen në mënyrë kolektive në dispozicion për shqyrtimin e komisioneve të recensionit gjatë periudhave për promovim të titujve mësimdhënës.

Zyra e cilësisë gjithashtu drejton anketën me studentët. Ky gjithashtu është një proces që merr opinionin e studentëve si dhe për secilin mësimdhënës së paku do të ketë një anketë për njëherë nga lëndët që ai ajo i ligjëron brenda një viti (dy herë nëse mësimdhënësi ligjëron në më shumë se në një cikël). Anketa është identike për secilën lëndë dhe këto anketa janë të qasshme në tri gjuhët që përdoren në nivel të Universitetit (shqip, maqedonisht dhe anglisht). Anketat e studentëve administrohen në përgjithësi nga këshilltarët studentorë të fakulteteve. Pasi përpunohen rezultatet, çdo mësimdhënës pranon një raport krejtësisht anonim të përgjigjeve nga studentët e tij/saj. Kjo bazohet në një shkallë me katër pikë dhe çdo kategori përfshin gjithashtu 'mesataren e fakultetit' dhe 'mesataren e universitetit' në mënyrë që mësimdhënësi të jetë në gjendje për të parë se si është performanca e tij ose e saj, të krahasohet me mesataren e fakultetit dhe të Universitetit. Këto raporte nga anketat e studentëve janë gjithashtu në dispozicion për t'u shqyrtuar nga komisionet recensuese gjatë periudhave të promovimit të titujve të stafit akademik.

#### ZYRA E CILËSISË ORGANIZON SESIONE TRAJNIMI DY HERË NË VJET PËR TË GJITHË STAFIN, DUKE U BAZUAR MBI NEVOJËN APO INTERESIN E IDENTIFIKUAR OSE TË KËRKUAR

Zyra e cilësisë, në periudhën e mbuluar nga ky raport ka mbikëqyrur zbatimin e iniciativës Vlerësimi i mësimdhënies (Teaching Assessment Poll-TAP) në dy fakultete. Kjo iniciativë është implementuar në dy fakultete të veçanta dhe janë bërë anketime shumë të përgjithshme me studentët për çdo lëndë të vetme që ofrohet nga fakulteti. Rezultatet janë përpunuar pastaj nga udhëheqësit e ekipeve (zakonisht, anëtarët e Bordit të Universitetit ose Ekipin ekzekutiv, që punojnë jashtë fakulteteve apo qendrave të tyre) kanë raportuar për mësimdhënësit individualë dhe dekanatet gjegjëse. Procedura TAP është në vazhdim e sipër.

Zyra e cilësisë mbikëqyr funksionimin efektiv të ekipeve të cilësisë së fakultetit. Këto janë ekipe të vogla të vullnetarëve të brendshëm të fakulteteve dhe palëve të interesuara të jashtme të cilët takohen për të diskutuar fushat e përmirësimit, sidomos për politikën e fakultetit, për planet e veprimit apo hartimin e kurrikulës. Edhe pse kjo ka qenë tradicionalisht një fushë e dobët e përmirësimit të cilësisë në UEJL, gjatë pranverës të vitit 2016 institucioni vuri në dukje një rritje të konsiderueshme në takimet dhe funksionimin e disa ekipeve të cilësisë dhe se puna është duke vazhduar.

Zyra e cilësisë në fund rregullon dhe mbështet vizitat e kampionëve të cilësisë. Aktualisht, dy kampionët e cilësisë së Universitetit janë Francis Owens dhe Malcolm Cook, të dy me përvojë shumë të madhe, profesionistë britanikë në lëmin e arsimit. Zakonisht një herë apo dy herë në vit, ata vijnë dhe kryejnë një rishikim institucional të bazuar mbi një temë të veçantë, të para-dakorduar (zakonisht, një fakultet ose dy, apo një temë të veçantë, siç janë 'hulumtimi' ose 'vlerësimi'). Vizitat e tyre ndihmojnë për të sugjeruar përmirësime nga perspektiva objektive e të huajve, por mbështetëse dhe më tej të mundësuar UEJL për të ruajtur trendet themelore minimale në arsimin e lartë evropian.

Siç mund të vërehet në këtë listë, ka mekanizma të shumta për sigurimin e cilësisë dhe të gjithë janë të dizajnuara për përmirësimin e brendshëm. Megjithatë, rreziku për këtë qëndron në mungesën e mekanizmave efikase të zbatimit. Zakonisht, këto raporte, këto sugjerime të trajnimit dhe rekomandimet e kampionëve të cilësisë bëhen personale për stafin akademik individual, vetëm kur ata të kenë takimin e tyre vjetor të vetëveprimit me menaxherin. Në këtë takim, dekani apo drejtori relevant lexon një përmbledhje të arritjeve individuale dhe vendos sfida për përmirësim. Përderisa ky proces mund të jetë shumë kolegial dhe i dobishëm, vitet e fundit janë vërejtur edhe objektiva të pakuptimta ("të marr pjesë në një konferencë në Greqi") ose zbatimin pashpjegueshëm i të të dhënave (një fakultet ka zëvendësuar të dhënat e vjetra të vëzhgimit në rastet kur mësimdhënësi individual nuk është vëzhguar në vitin aktual. Duhet të jetë sfidë për vitet e ardhshme që UEJL të zhvillojë objektiva më efektive dhe më të zbatueshme, për përmirësim, veçanërisht që mund të maten në mënyrë më objektive.

## NJËSITË AKADEMIKE DHE OFERTA

### PËRSHKRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT

UEJL ofron mësimin në të tri ciklet e arsimit të lartë në të gjithë pesë fakultetet. Në kohën e këtij raporti, këto oferta përbëjnë 11 programe studimore të ciklit të parë të, 30 programe studimore të ciklit të dytë si dhe 12 programe studimore të ciklit të tretë. Shumica e formulimeve aktuale të programeve janë ndërmarrë në një shqyrtim të madh të akreditimit të ndërmarrë në vitin akademik 2011-2013. Natyrisht, programet individuale janë modifikuar dhe riakredituar që atëherë, por 2011-2012 ishte rishikimi i fundit i gjithë programeve studimore të universitetit (një përpjekje e ngjashme është duke u ndërmarrë në semestrin dimëror 2016-2017).



Programet janë të gjitha në përputhje me ndarjen e kërkuar ligjore të lëndëve edhe atë 60% lëndë të detyrueshme, 30% lëndë zgjedhore brenda fushës dhe 10% 'zgjedhore të lira, të cilat janë lëndë të ofruara në të gjithë Universitetin për udhëzim të përgjithshëm dhe për zhvillim e kureshtje. Lëndët e detyrueshme dhe zgjedhore janë akredituar në kuadër të programeve, ndërsa ato 'zgjedhore e lira' janë akredituar në përgjithësi për të gjithë Universitetin dhe administrohen në mënyrë të pavarur nga fakultetet individuale.

Kurrikulat diskutohen në hollësi në seksionet individuale, por ajo që është e vërtetë për të gjitha kurrikulat në të gjithë Universitetin është se ato kanë për qëllim të jenë të cilësisë dhe rëndësisë ndërkombëtare, me një nivel të lartë të mendimit të pavarur kritik të inkurajuar dhe të përgatitin studentët për të bërë një nga dy gjëra pas përfundimit të studimeve – ose të hyjnë në tregun e punës apo të vazhdojnë ciklin e ardhshëm të studimeve.

Kjo zbatueshmëri e aftësive është vendimtare; Universiteti ka identifikuar si nevojë të madhe (për vëzhgim dhe zhvillim në të ardhmen) një fokus të vazhdueshëm mbi gatishmërinë e tregut për të diplomuarit, si dhe zbatueshmërinë e tyre në vendin e punës. Universiteti beson se kjo pikësëpari është kombinim i shkathtësive teknike, zbatimit praktik të aftësive për zbulimin dhe zgjidhjen e problemeve, si dhe shkathtësitë për autonomi dhe vetë-motivim. Prandaj, këto janë tre elemente kryesore të destinuara për t'u zhvilluar nga kurrikulat akademike të UEJL-së.

Parimet kryesore të UEJL gjatë dizajnit të kurrikulave janë: lëndët duhet të jenë relevante për nevojën dhe interesin e studentëve; duhet të jenë të zbatueshme në lëmenjtë përkatës; lëndët duhet të kenë marrëdhënie të qarta me lëndët tjera nga programi; mekanizmat e vlerësimit të performancës së studentëve duhet të jenë të përshtatshme dhe të ndryshme; progresioni vit për vit duhet të përbëjë kompleksitetin dhe vështirësinë e detyrave; një i diplomuar i suksesshëm duhet të jetë në gjendje të vazhdojë zbatimin praktik në fushën përkatëse ose të vazhdojë studimin e avancuar akademik të kësaj fushe. Duhet të theksohet se ka një besim të përhapur në të pesë fakultetet- se këto parime të përgjithshme zakonisht respektohen, por ka edhe shumë oferta të lëndëve individuale që janë propozuar më pak për përdorim të studentëve apo interes se për shkak se mësimdhënësit dëshirojnë t'i ofrojnë këto tema specifike ose mësim. Është për të shprehur se në të ardhmen interesi dhe nevoja e studentëve gjithmonë do ta shfuqizojë interesin e instruktorëve, nëse ka ndonjë konflikt në mes të dyjave .

dhe statusin e shkollimit (faturat që kanë nevojë për t'u paguar). Përveç kësaj, studentët kanë mundësi që në masë të madhe të marrin vendime vetë në caktimin orarit duke u regjistruar elektronikisht në lëndët që ata duhet t'i ndjekin ose kanë dëshirë (subjekt i mbikëqyrjes të qartë në lidhje me madhësinë e klasës dhe përshtatshmërinë e vendndodhjes fizike). Së fundi, MySEEU është përdorur shpesh nga administrata e Shërbimeve studentore që të postojnë njoftime të rëndësishme, të tilla si ndodhja e një feste kombëtare që mund të shtyjë mbajtjen e një lënde ose publikimin e një orari të provimit.

Brenda kampusit, siç u tha, në të shumtën e rasteve, njoftimi mbetet të bëhet në formë elektronike. Megjithatë, njoftimet e rëndësishme janë postuar shpesh në fushat e rëndësishme së duhur bëhen edhe në forma të tjera (kështu, për shembull, orari konsultime nga instruktorët postohet në dyert e tyre të zyrës). Në mënyrë të ngjashme, për studentët e magjistraturës dhe doktoratës (të cilët zhvillohen në fundjavë), ka orare ku postohen për t'i informuar se kush nga fakulteti dhe zyrtarët e menaxhmentit janë në detyrë atë ditë dhe ku mund të gjenden këta njerëz.

Së fundmi, studentët kanë qasje të përgjithshme në të gjitha burimet elektronike të Universitetit, duke përfshirë sistemin e-mailit, ueb faqen, katalogun online të bibliotekës dhe burime të tjera të ngjashme dhe ata mund të zgjedhin gjithashtu të marrin pjesë në angazhim shtesë në mënyrë elektronike (si, për shembull duke bërë "friending" faqen e Fejsbukut të Universitetit).

## STRUKTURA E SHËRBIMEVE STUDENTORE

UEJL është lider rajonal në ofrimin e shërbimeve efektive dhe të dokumentuara të studentëve. Ky është një burim i krenarisë së Universitetit sepse shërbimet e studentëve punojnë me arritje të qëndrueshme për t'i ndihmuar dhe për t'i informuar studentët dhe për t'i zgjidhur problemet dhe ankesat e tyre. Shërbimet studentore për këtë raport kanë për qëllim t'i përfshijnë funksionet e mëposhtme që kryhen në nivel të Universitetit: pranimin, planifikimin akademik, bursarin, ndihmën financiare dhe regjistrimin.

Çdo fakultet ka një këshilltar studentor individual. Po ashtu edhe kampusi në Shkup ka një për të gjithë studentët. Puna e tij është që t'i ndihmojë studentët dhe t'i përfaqësojë ata po të ketë nevojë. Kjo punë është e ndarë nga funksionet administrative të fakultetit. Këshilltari studentor, ndërkaq, i shërben studentët me këshilla më shumë se ai ose ajo që bëjnë administrimin e Fakultetit. Në praktikë kjo do të thotë të ndihmosh në planifikimin dhe zgjidhjen e konflikteve, duke i këshilluar studentët në përzgjedhjen e lëndëve. Po ashtu kjo do të thotë të bësh përpjekje t'i zgjidhen mosmarrëveshjet apo konfuzionet në mes të studentëve dhe instruktorëve, duke paralajmëruar studentët që mund të jenë në rrezik të dështimit përmes performancës së dobët akademike apo prezencën e pamjaftueshme dhe në përgjithësi të ndihmohen studentët në vështirësitë që ata mund t'i kenë. Ekziston edhe një këshilltar studentor për studimet e magjistraturës i ngarkuar posaçërisht me këto detyrime, por i shërben vetëm studentët e magjistraturës. Kjo e çon numrin këshilltarëve studentorë deri në shtatë veta.

Në nivel të Universitetit, Shërbimet studentore përsëri ofrojnë ndihmë gjatë gjithë ciklit të jetës studentore, nga aplikimi deri tek diplomimi. Të gjitha materialet e aplikimit janë përpunuar përmes Shërbimeve studentore dhe jepen këshilla për ndonjë material shtesë të nevojshëm. Njoftimet për pranim dërgohen përmes Shërbimeve studentore edhe pas regjistrimit. Shërbimet studentore mbeten të përfshirë në përvojën akademike të studentit gjatë gjithë jetës studentore. Një student, pra, do të presë që të angazhohet me Shërbimet studentore në kontrollimin e transkriptit; do të ndihmojë për të rihapur një llogari të bllokuar; oraret e mësimit, oraret e provimeve; përpunimin e rezultateve të provimeve (njoftimet elektronike për notat u dërgohen studentëve, të gjitha notat regjistrohen edhe në shërbimet studentore në kopje në letër të nënshkruar nga profesori individual kur cakton notën për vlerësimin); aplikimin dhe pjesëmarrjen në një program për bursa ose programin puno dhe studio; marrjen e orarit për mësim; dhe më në fund, shpresohet, në përpunimin e kërkesës për diplomim dhe marrjen e diplomës.

Duhet të theksohet se ky seksion detajon vetëm ato funksione që janë të shprehura në mënyrë të qartë si të Shërbimeve studentore. Studentët në mënyrë rutinore marrin ndihmë nga administratorët e fakulteteve, mësimdhënësit, punëtorët e mirëmbajtjes dhe kapacitetet teknike, stafi i Qendrës së karrierës, si dhe stafi i bibliotekës në kryerjen normale të punës së tyre. Kështu, në kohën e këtij raporti, Shërbimet studentore përbëhen nga shtatë Këshilltarët studentorë të përmendur, me nëntë veta personel shtesë administrativ që punon nën drejtimin e drejtorit të Shërbimeve studentore. Prandaj, ka një total prej shtatëmbëdhjetë ofruesish të drejtpërdrejtë të shërbimeve studentore.

## SHËRBIMET E BIBLIOTEKËS

Ndihma në bibliotekë është në dispozicion për të gjithë studentët, me kohë të plotë ose me kohë të pjesshme, dhe të gjithë stafin. Shërbimet kryesore të ofruara janë natyrshëm në vendndodhjen dhe ofrimin e librave në bibliotekë në të dy kampuset. Stafi bibliotekës gjithashtu ndihmon në kontrollin, kthimin dhe rivendosjen e librave që kanë qenë të huazuar nga studentët ose anëtarët e stafit. Kërkesat për "rezervimin" e librave mund të bëhen personalisht ose online. Materialet joreferuese zakonisht mund të huazohen dhe të rinovohet kërkesa edhe pse për veprat veçanërisht të njohura ose të rralla mund të refuzohet një kërkesë për të ripërtërirë një libër kontrolluar.

Nëpërmjet bibliotekës Universiteti është i lidhur edhe me disa baza të të dhënave hulumtuese, më e rëndësishmja është EBSCOhost. Biblioteka ka monitoruar dhe ka ruajtur këtë lidhje dhe ka siguruar trajnim mbi materialet gjetjen në këtë dhe në bazat e të dhënave të tjera në dispozicion.

Materialet në dispozicion në bibliotekë janë kataloguar në katalogun online. Kjo është ajo ku artikujt e ri renditën gjithashtu dhe të gjithë të interesuarit për blerjet e reja mund t'i shohin përditësimet e rregullta në faqen e katalogut online.

Biblioteka gjithashtu shërben si vend qendror për shfaqje të atyre dokumenteve që janë vënë në dispozicion të komunitetit para se të paraqiten në Këshillin akademik të Fakultetit, të tilla si disertacioneve magjistraturës ose doktoraturës në pritje mbrojtjes, ose raportet e recensioneve për proceset promovuese në thirrje. Biblioteka gjithashtu si vend për ruajtje tezave të magjistraturës dhe doktoratës pas mbrojtjes së tyre, në mënyrë që ata janë në dispozicion për konsultim shkencore.

## BASHKËPUNIMI I JASHTËM

### BASHKËPUNIMI ME INDUSTRIJË, INSTITUCIONET QEVERITARE, OJQ-TË DHE SHOQATAT E TJERA PROFESIONALE

Universiteti i Evropës Juglindore, që nga themelimi është angazhuar për të qenë një partner i komunitetit në vendet ku operon. Kjo përfshin sfidën e mirëpritur të ndërtimit dhe mirëmbajtjes së marrëveshjes e të bashkëpunimit me institucionet tjera jo-akademike, përveç përpjekjeve bashkëpunuese të ndërmarra nga UEJL me universitete të tjera të rajonit.

Bashkëpunimi me industrinë është i bazuar kryesisht në interes të ndërsjellë. Qendra për zhvillimin e biznesit është projektuar për ta nxitur UEJL si një partner dhe vitalizmin më të madh të shërbimit të ofruesit të industrisë vendase, veçanërisht në kontekstin e formimit apo zhvillimit të programit. Qendra e karrierës gjithashtu mban kontakte të rregullta me bizneset lokale, në mënyrë që të mësojë për mundësitë e punësimit për të diplomuarit dhe për të ndihmuar në vendosjen e studentëve për të përmbushur kërkesat e tyre praktike. SEEUTechPark është projektuar për të shërbyer edhe si një qendër teknologjike dhe një zonë e inkubacionit të biznesit, por është ende një përpjekje në zhvillim. Programet e fundit të studimeve të integruara janë projektuar për të siguruar studentët me një balancë në mes të 50% të studimit në klasë dhe 50% të punës praktike në biznes. Së fundi, kur është e përshtatshme, biznesi dhe industria kanë bashkëpunuar me fakultetet si partnerë ose ofrues të këshillave të palëve të interesuara të jashtëm (d.m.th që marrin pjesë në diskutimet e ekipeve të cilësisë). Partnerët e fundit të industrisë apo bashkëpunëtorët përfshijnë: Dauti Komerc, Ecolog, dhe kompani të tjera rajonale dhe kombëtare. UEJL ka edhe një marrëveshje ‘*Education Alliance*’ me Microsoft-in.

Bashkëpunimi me institucionet qeveritare është e bazuar kryesisht mbi harmonizimin e ekspertizës së UEJL me nevojat e qeverisjes qendrore apo komunale. Duhet të theksohet se qeveria kohëve të fundit (viti akademik 2015-2016) ka dhënë një subvencion të dukshëm për të UEJL-së dhe ky investim ka mundësuar institucionin dhe qeverinë për thellimin e lidhjeve bashkëpunuese. Profesorët e UEJL janë anëtarë në Bordin e akreditimit, janë anëtarë në ASHAM dhe kanë ofruar këshilla dhe mbështetje për Ministrinë e Arsimit. Në nivel komunal, UEJL ka mbajtur marrëdhënie të mira edhe me përfaqësuesit e qeverisë dhe ka punuar në bashkëpunim të drejtpërdrejtë veçanërisht në komunën e Tetovës. Në këtë aspekt vlen të përmendet përpilimi i Plan veprimi klimaterik i komunës nga UEJL dhe krijimi i një serie të sistemeve të monitorimit për ndotjen. Universiteti

mbetet i gatshëm për të ofruar ndihmë bashkëpunuese për ministritë e Qeverisë së RM-së dhe në komunat në të cilat operon UEJL, aty ku ekspertiza jonë është e dëshiruar.

UEJL kërkon, inkurajon dhe vlerëson lidhjet me OJQ-të. Universiteti mbetet i gatshëm për të bashkëpunuar me OJQ-të në fushat ku aftësitë tona përkojnë me nevojat e OJQ-së dhe ku ekspertiza jonë mund të jetë e dobishme. Kështu, për shembull, UEJL ka bashkëpunuar frytshëm me OJQ "Loja" në Tetovë, veçanërisht në hartimin dhe ofrimin e kurseve për universitetet e shumta në multikulturalizmin, për të cilat instruktorët e UEJL-së kanë ligjëruar dhe në të cilin studentët nga UEJL kanë marrë pjesë. UEJL ka ndërtuar marrëdhënie të mira me Romaversitas, një organizatë e projektuar për të nxitur dhe për të ndihmuar përfshirjen e nxënësve romë në arsimin e lartë. Që nga nënshkrimi i një marrëveshjeje bashkëpunimi, Romaversitas ka hapur një zyrë në kampusin e UEJL-së në Tetovë dhe Universiteti ka ofruar disa kurse me kërkesë të veçantë për studentët pjesëmarrës romë.

Universiteti ka qenë udhëheqës në një projekt të përbashkët USAID - Lions Club International për të ndihmuar fëmijët me shikim të dëmtuar në Republikën e Maqedonisë. Ky projekt ka si qëllim monitorimin dhe zbulimin e problemeve të shikimit të nxënësve të cilët përndryshe nuk mund të kenë qasje në kujdesin mjekësor të duhur të syve, për të ndihmuar ata të cilët mund të kenë nevojë për syze ose mbështetje shtesë dhe për të prodhuar dhe për të siguruar libra në gjuhën maqedonase dhe shqipe në alfabetin Brejll.

Universiteti mbetet i përkushtuar për t'i shërbyer komunitetit, jo vetëm si një ofruar i arsimit, por edhe si një partner profesional për bizneset, OJQ-të, zyra qeveritare dhe bashkëpunëtorëve të tjerë të mundshëm në komunitet.

#### PJESËMARRJA NË PROGRAMET EVROPIANE NË PESË VITET E FUNDIT

Universiteti i Evropës Juglindore në mënyrë aktive kërkon bashkëpunim dhe pjesëmarrje të përbashkët në programe me kolegët dhe institucionet evropiane. Megjithatë, është disi e vështirë të matet me saktësi shkalla e "pjesëmarrjes në programet evropiane në pesë vitet e fundit", më së shpeshti për shkak se pjesëmarrja nuk është gjithmonë e plotë institucionale apo është joformale dhe programet nuk mund të kenë efekt të mjaftueshëm. Kështu, në vitin akademik 2015-2016, një nga anëtarët e stafit të UEJL-së ka ligjëruar me ftesë në Universitetin Dalarna në Suedi për dy javë dhe e bëri këtë në një marrëveshje formale; në mënyrë të ngjashme, në të njëjtën periudhë, një prej stafit akademik mbajti një seri leksionesh i ftuar në Universitetin Shtetëror Tbilisi, por këtë e bëri nga kontakti individual dhe joformal. Këto ishin të dy në kuadër të programeve akademike të institucioneve nikoqire, por kjo e fundit nuk ishte pjesë e programeve formale të mobilitetit.

Universiteti është angazhuar në rreth njëzet programe evropiane në periudhën e mbuluar, duke supozuar se një përkufizim konservativ i këtyre termave kuptohet. Universiteti ka marrë pjesë në disa programe të TEMPUS-it, si dhe marrëveshjeve institucion-për-institucion, siç është bashkëpunimi me Universitetin Gjovik në Norvegji. Ka iniciativa të shumta individuale të stafit për lëvizshmëri dhe bashkëpunim, por, në këtë seksion,

një matje konservatore ka qenë aplikuar për të përcaktuar bashkëpunimin institucional, në vend të programeve të veçanta kryesisht të fakulteteve.

#### MOBILITETI I STUDENTËVE DHE I STAFIT

Mobiliteti i studentëve dhe i stafit është një element i rëndësishëm në zhvillimin e Universitetit. Në përputhje me rrethanat, UEJL vendos një vlerë të lartë në përdorimin e mundësive të mobilitetit. Fakultetet kanë treguar zell të rëndësishëm në kërkimin e mundësive specifike të lëvizshmërisë në terren. Duhet pranuar, megjithatë, se lëvizshmëria pengohet shpesh nga disa faktorë. Ndër këto, më i dukshëm do të jetë: 1) kostoja relativisht e lartë e vendeve të destinacionit (veçanërisht në vendet e BE) për studentët dhe stafin e UEJL-së, 2) mungesa krahasuese tërheqëse e RM për studentët mobilitet ardhës dhe 3) vështirësia për stafin të marrë kohë të lirë nga oraret e punës për të marrë pjesë në mundësitë e mobilitetit për stafin. Gjithashtu është problem që disa këshilla të fakulteteve kanë kundërshtuar në mënyrë retroaktive marrëveshjet e të mësuarit, duke shkaktuar që studentët që kthehen nga mobiliteti të mos i marrin kreditë e plota ECTS për përvojën e tyre në mobilitetit. Ky problem duhet të adresohet me aplikimin e një politike ose rregulloreje në Universitet në përgatitjen e marrëveshjeve të të mësuarit dhe cilësive të tyre të detyrueshme.

Në vitin akademik 2015-2016, 12 studentë shkuan në mobilitet dhe 4 anëtarë të stafit (3 akademikë dhe 1 administrativ) kanë marrë pjesë në programet e mobilitetit. Në vitin akademik 2014-2015, 27 studentë kanë marrë pjesë në Erasmus + mobilitet dhe 6 nëpërmjet Basileus. Në vitin akademik 2013-2014, 10 studentë shkuan në Erasmus mobilitet, si dhe një anëtar i stafit (mënyrë plotësuese, në këtë vit ka pasur disa studentë dhe instruktorët nga SHTB që shkuan në Gjøvik sipas marrëveshjeve të pavarura). Në vitin akademik 2012-2013 ishin 3 studentë dhe 1 anëtar i stafit i cili vazhdoi mobilitetin (kjo rënie e mprehtë pasqyron faktin që në këtë vit akademik, mbështetja financiare ishte vendosur në një normë të sheshtë prej 350 eurosh në muaj dhe nuk ndryshohej sipas vendndodhjes, duke e bërë mobilitetin për kudo në BE në thelb të pamundur për arsye financiare). 2012-2013 ishte viti i parë që shënoi hapjen e programit Erasmus në Maqedoni; nga viti 2012 deri më sot (përfshi edhe studentët aktualisht në e mobilitetit), ka pasur gjithsej 63 studentë dhe 6 të punësuar në programet formale të mobilitetit.

Marrëveshjet e mira e mobilitetit dhe aranzhimet do të jenë vendimtare për zhvillimin e ardhshëm të institucionit. Mobiliteti tani është integruar në kërkesën për t'u kualifikuar për mbrojtjen publike të tezës së doktoratës dhe kjo është bindja e UEJL-së se lëvizshmëria e personelit do të jetë një mundësi e madhe për shkëmbime hyrëse dhe dalëse të mësimdhënies në vitet e ardhshme.

#### DIMENSIONI NDËRKOMBËTAR I PROGRAMEVE STUDIMORE

UEJL ka qenë e orientuar ndërkombëtarisht që nga themelimi, sidomos që është mbështetur fillimisht me bujari të tillë nga qeveritë donatore dhe ambasadat e tyre. Universiteti Indiana ishte gjithashtu një ndikim i madh në ndërtimin e strukturave fillestare të Universitetit dhe programet e ofruara. Që nga këto kontakte

fillestare, Universiteti ka mbetur i fokusuar në ruajtjen e marrëdhënieve ndërkombëtare me institucionet kolegjiale; për hartimin dhe ofrimin e arsimit cilësor ndërkombëtar dhe në njohjen e përgjegjësive për mangësitë tona institucionale në krahasim me partnerët dhe udhëheqësit ndërkombëtarë.

Në kushtet e programeve specifike të studimit të ofruara nga pesë fakultetet ka elemente të shumta me të cilat ndërkombëtarizimi i kurrikulës është i garantuar. Çdo fakultet ka qenë kohët e fundit i vlerësuar nga një ekspert ndërkombëtar ose ekipi i ekspertëve; përgjegjësia e tyre ishte për të siguruar që ofertat akademike të UEJL-së të jenë në pajtim me standardet ndërkombëtare. Fakultetet e biznesit dhe ekonomisë; i Shkencave dhe teknologjive bashkëkohore dhe i Gjuhëve, kulturave dhe komunikimit të gjithë e kishin vlerësues nga Universiteti i Indianës; i Drejtësisë priti një ekip ekspertësh nga Universiteti i Zagrebit; dhe i Administrimit publik dhe Shkencave politike organizoi një ekspert nga Universiteti i Lubjanës.

Në hartimin e kurrikulave, dekanët dhe këshillat e fakulteteve të UEJL-së janë inkurajuar që t'i bazojnë vendimet e tyre kurrikulare dhe hartimin e kurrikulës në krahasim me programet e ngjashme në universitetet prestigjioze në mbarë botën. Ky proces është ndërmarrë me kujdesin e duhur për respektimin e të drejtave të pronësisë intelektuale të institucioneve të tjera, natyrisht, por në vija të përgjithshme këto krahasime ofrojnë dëshmi të vlefshme për pajtueshmërinë e programeve të UEJL-së me ato të universiteteve të ngjashme.

Stafi dhe studentët inkurajohen të shkojnë në programet e mobilitetit kur janë në dispozicion. Studentët e doktoratës tani duhet të kryejnë mobilitet ndërkombëtar para se ata të lejohen të aplikojnë për mbrojtje publike të tezës së tyre.

Shumica e burimeve të përdorura në lëndët e veçanta – tekstet e caktuara, materialet e të mësuarit, ushtrimet e parashikuara, burimet online – kryesisht sigurohen nëpërmjet përkthimit nga burime ndërkombëtare.

Ligjëruesit mysafirë vijnë shpesh nga jashtë dhe profesorët vizitues janë të inkurajuar për të ofruar udhëzime brenda dispozitave të ligjit të "mësimin klinik". Në mënyrë të ngjashme, ato pjesëmarrësit në programet e shkëmbimit të qeverisë (siç është programi amerikan Fulbright) japin leksione dhe në disa raste kanë ofruar trajnim për stafin dhe mentorim për kandidatët në ciklin e 2 dhe 3 (para kërkesës qeveritare të akreditimit).

Anëtarët e stafit ndërkombëtar janë zhdukur kryesisht nga stafi i Universitetit i angazhuar me kohë të plotë. Ka disa shtetas të Shqipërisë, që japin mësim në UEJL, dhe një qytetar i SHBA-ve që ligjëron në GJKK. Është edhe një angleze në Zyrën e cilësisë i cila nuk ligjëron. Disa shtetas turq që ligjërojnë në mënyrë të parregullt për të akomoduar programin e gjuhës turke në Fakultetin e drejtësisë. Ka dy shtetas gjermanë të angazhuar në UEJL, një me kohë të pjesshme si mësimdhënës i gjuhës në Departamentin e gjermanishtes dhe një duke vepruar si këshilltar i programeve në studimet e integruara.

## KONTAKTET ME ALUMNIN

Kontaktet me Alumnin kryesisht mbahen nga Qendra e karrierës. Qendra e karrierës kryen anketime me Alumnin, veçanërisht në lidhje me punësimin dhe përshtatshmërinë e kurrikulave me vendet e punës në treg. Qendra gjithashtu u dërgon njoftime të diplomuarve për mundësitë e punësimit.

Disa alumni zgjedhin të mbeten të përfshirë në Universitet, veçanërisht në kontekstin e ndihmës vullnetare (siç është një gatishmëri për të ofruar mundësi praktike për studentët aktualë të UEJL-së), ose duke shërbyer si këshilltarë të jashtëm mbi rishikimet kurrikulare dhe dizajnimin.

Duhet pranuar, megjithatë, se marrëdhëniet me Alumnin janë një dështim i thellë i institucionit. Struktura e Universitetit parashikon që Asociacioni i Alumnit të jetë aktiv; por përkundër kësaj nuk janë takuar për vite me radhë. Në thelb nuk është bërë asnjë përpjekje e vazhdueshme për të mbajtur alumnin të përfshirë në jetën e Universitetit, me përjashtim të rastit të përpjekjeve individuale ose kontakte nga Qendra e karrierës.

Të diplomuarit e interesuar kanë avancuar propozimet e mëposhtme për të nxitur formimin dhe punën aktive të Asociacionit të Alumnit: të lejohen të diplomuarit të mbajnë llogaritë e tyre të emailit të UEJL-së pas diplomimit; kartat e identitetit të Asociacionit të Alumnit që do të mundësojnë që të vazhdojnë t'i përdorin shërbimet e Universitetit (p.sh., qasja në bazën e të dhënave ose mundësia për të huazuar libra); të organizojnë më shumë ngjarje të rregullta sociale në kampus të drejtuara nga Alumni, veçanërisht në bazë të fakultetit dhe të bëhet një gazete apo të startojnë me punë disa medime sociale të projektuara ekskluzivisht për interesin e Alumnit. Ky hap mund të jetë me vlerë duke pasur parasysh qëndrueshmërinë e këtyre sugjerimeve, pasi kontaktet e tanishme me Alumnin janë të pamjaftueshme.

## AKTIVITETI I HULUMTIMEVE SHKENCORE

Universiteti i Evropës Juglindore pranon se hulumtimi është vendimtar për reputacionin individual dhe institucional të stafit tonë dhe të mbarë Universitetit. Prandaj, Zyra për hulumtim është projektuar për të ofruar ndihmë në të gjitha fushat e hulumtimit, si: përidentifikimin e mundësive të mira për aplikimet për projekte; për shpërndarjen e thirrjeve për punime në konferenca me reputacion dhe kongrese; njoftimin e stafit në lidhje me botuesit e papërgjegjshëm dhe mënyrën si të zbulohen dhe si të shmangen ata; prodhimin revistës shkencore SEEU Review; për të ndihmuar organizimin dhe mbajtjen e konferencave nga fakultetet apo qendrat e UEJL-së; dhe për asistimin e stafit për të pasur qasje në buxhetet e tyre të deleguara për mbështetjen e hulumtimit.

Në vitin akademik 2015/2016, Zyra për Hulumtim ka miratuar mbështetje financiare për pjesëmarrje në konferencë dhe publikim në total prej 59,953 eurosh, të shpërndara në mesin e fakulteteve në këtë mënyrë: B & E-14190; GJKK-9056; AP&SHP-8680; Drejtësi - 5609; SHTB -11446; QGJ-10972. Konvertimi i valutës ka bërë

për shumë përshtypje të vogla në këto numra, si disa kërkesa mbështetje kërkimore ishin për vende që nuk përdorin as denarë ose euro.

Duhet të theksohet se prioritetet e hulumtimit dhe struktura kanë ndryshuar ndjeshëm në pesë vitet e fundit. Më parë rasti Zyra e hulumtimit kontrollonte një buxhet të centralizuar dhe se mbështetja publikimit ishte në qendër kryesisht ndihmë për pjesëmarrje në konferenca dhe botimi i teksteve universitare. Dy vjet më parë (nga koha e këtij raporti), struktura u rishikua ndjeshëm, dhe çdo anëtar i stafit akademik i është mundësuar qasje me deri në 700 euro në vit për të mbështetur pjesëmarrjen e tyre në konferencë apo për t'i mbështetur ata të publikojnë. Që nga ajo kohë, nuk është ndarë buxhet për përkrahjen e botimit të librit nga ana e shtypit të Universitetit të EJL.

Ky ndryshim në politikë, sigurisht, ka pasur ndikime të konsiderueshme, në publikimin e librave nga stafi pasi ka rënë numri i publikimeve (në mungesë të publikimit të librave të stafit të Universitetit), por ka rritje të publikimeve në revista dhe punime të konferencës. Të dyja këto janë shqyrtuar në rangimin nga Universiteti i Shangait Jiao Tong. Megjithatë botimet e librit duket se kanë peshë më të madhe në këtë proces, prandaj Universiteti duhet ta rishqyrtojë financimin e Zyrës për hulumtim dhe ta ndryshojë politikën e ofruar 700 euro për çdo anëtar të stafit akademik. Një modifikim është i mundur që të caktohet një buxhet qendror për hulumtime për mbështetjen e publikimeve nga Zyra për hulumtim, për të cilat stafi do të aplikojnë për ndihmë për publikimin e librave, teksteve univerisatre ose publikimin e revistave. Kjo është arsyeja që duhet të delegohet një pjesë e buxhetit të hulumtimit tek dekanët (me ose pa mbikëqyrje nga Prorektori për hulumtimin), i cili do të jetë në gjendje të ndajë mbështetje më të madhe konferencash për hulumtuesit më produktivë dhe më pak mbështetje për hulumtuesit joproduktivë ose inertë.

#### NUMRI I PUBLIKIMEVE NË PESË VITET E FUNDIT

Publikimet e mëposhtme janë regjistruar nga stafi i UEJL-së në pesë vitet e fundit: 2012-2015, stafi i UEJL ka publikuar gjithsej 77 libra, 1086 artikuj në revista të recensuara, nga të cilat 21 ishin artikuj në revista të njohura në *Web of Science*.

#### *Numri i përgjithshëm i aplikacioneve për projekte në pesë vitet e fundit dhe i projekteve të realizuara*

Ka qenë e pamundur të sigurohet një numër i saktë i aplikimeve për projekte në pesë vitet e fundit, pasi nuk është mbajtur asnjë regjistër qendror. Për asnjë proces nuk kërkohet që fakultetet individuale ose qendrat ta njoftojnë Rektoratin ose Zyrën e hulumtimit për aplikime të tilla. Kjo do të thotë se aplikimet e dështuara ose të refuzuara nuk regjistrohen dhe gati është e pamundur ato të kuantifikohen pas pesë viteve, duke shtuar këtu si pengesë edhe pensionimin e stafit, dorëheqjen, ose variabla të tjera.

Prandaj do të ishte rekomandimi i Komisionit të vetëvlërësimit që Rregullorja për hulumtim të modifikohet për të kërkuar që çdo individ, program, fakultet, apo organizatë në UEJL ta njoftojë Zyrën për hulumtim dhe



Instituti Max Van der Stoel të mbajë evidencë për aplikimet, individët e përfshirë, çdo institucion bashkëpunues dhe për rezultatet e këtij aplikimi në projekt.

#### PJESËMARRJA NË SEMINARE, KONFERENCA DHE ASAMBLE SHKENCORE NË PESË VITET E FUNDIT

Ka qenë e pamundur të përcaktohet sasia, pasi Universiteti ka të dhënat jo të plota të pjesëmarrjes në konferenca para vitit akademik 2014-2015. Për vitet akademike 2014-2015 dhe 2015-2016 të dhënat e Zyrës për hulumtim ka regjistruar vetëm ato pjesëmarrje në konferencë që janë të mbështetura financiarisht nga Universiteti i Evropës Juglindore. Prandaj është shumë e mundshme që janë ndërmarrë shumë 'kuvende shkencore' pa kërkuar fonde për konferencë dhe çdo individ i cili nuk ka kërkuar mbështetje për hulumtim nuk është regjistruar.

Ne mund, megjithatë, të bëjmë vlerësime të arsyeshme brenda kufijve të variablave të shpjeguara. Në vitin akademik 2015-2016 ka pasur fonde hulumtuese të miratuara për pjesëmarrje në 146 konferenca (ose, më saktësisht, 146 kërkesa të veçanta për ndjekjen e konferencës janë miratuar, disa prej tyre ishin individë që shkojnë në më shumë se një konferencë dhe disa individë kanë marrë pjesë në të njëjta konferenca me kolegë të tjerë). Në vitin akademik 2014-2015, kërkesat individuale për pjesëmarrje në konferencë arriti në 82 kërkesave individuale të miratuara, edhe pse përsëri disa prej tyre ishin individë që kanë bërë kërkesa të shumta, ose grupeve të individëve që ndjekin të njëjtën konferencë.

Meqë se politika e alokimit për stafin akademik 700 euro secilit për mbështetjen e hulumtimit u kuptua më mirë në vitin e parë sesa në të dytën, ka më shumë të ngjarë që viti i parë (14-15) të jetë i përfaqësuar më mirë me pjesëmarrjen e mundshme në konferenca se sa në tre vitet e mëparshme, për të cilat nuk ekzistojnë të dhëna. Prandaj, kjo do të duket e arsyeshme të bëhet një vlerësim konservativ, por të arsyeshëm për 2011-2012, 2012-2013, dhe 2013-2014 për rreth 70 pjesëmarrje në konferenca, që janë pak më pak se ato të regjistruara në vitin 2014-2015 dhe rritja dukshëm është më e ulët se rritja e dëshmuar e pjesëmarrjes në konferenca në vitin akademik 2015-2016. Prandaj, do të japim një vlerësim që e pranojmë ndoshta si të pasaktë, por në përgjithësi është i arsyeshëm për 438 pjesëmarrje në konferenca për periudhën në fjalë pesë vjeçare.

#### NUMRI I PËRGJITHSHËM I KUVENDEVE SHKENCORE TË ORGANIZUARA NË PESË VITET E FUNDIT

Kjo kategori përsëri është jashtëzakonisht vështirë të matet e të vlerësohet si një kuvend shkencor i organizuar që mund të mbulojë çdo gjë nga një konferencë në shkallë të plotë të njëqind akademikëve vizitorë, një seminar i të diplomuarve për të paraqitur risi për hulumtim për disa profesorë të jashtëm të ftuar. Prandaj është kuptim themelor i këtij Raporti të vetëvlerësimit se 'Kuvende shkencore organizuara' do të përfshijë vetëm ato konferenca akademike që kanë sjellë së bashku akademikë, që përfaqësojnë institucione të shumta dhe që përfshijnë disa mënyra të aplikimit dhe procedurën e pranimit.

Duke supozuar një përkufizim dhe duke përjashtuar seminarët, prezantimet, ligjëratat formale vetëm nga një prezantues, si dhe kuvendet e tjera të ngjashme, duket që UEJL me të drejtë mund të pretendojë se ka organizuar 17 konferenca ose takime që do të plotësojnë kriteret e vendosura. Të gjitha fakultetet kanë pritur të paktën një dhe në të shumtën e rasteve konferenca apo kuvende të shumta. Disa departamente apo katedra kanë nga tre ose katër tubime të mbajtura vetë në këtë periudhë. Përveç kësaj, njësitë brenda Universitetit kanë mbajtur edhe kongrese apo konferencat e tyre, duke përfshirë edhe Institutin hulumtues Max Van der Shtul, Zyrën e cilësisë dhe Njësinë e biotikës..

#### NUMRI DHE PËRSHKRIMI I PROFESORËVE VIZITUES SHKENCORE

Sipas modelit, kjo nuk është e përgjithshme për pesë vitet e fundit, por me sa duket ka për qëllim të bëjë me ata që aktualisht janë staf në kohën e raportit. Prandaj, profesor vizitues aktualisht në UEJL në kohën e paraqitjes së këtij raporti është Prof. Paul Koku, një vizitor Fulbright i sponsorizuar nga mirësia e qeverisë së Shteteve të Bashkuara. Prof. Koku vjen në UEJL nga Universiteti Atlantik Florida. Ai ka një J.D. nga Florida *State University Law School*, dhe një doktoratë në Financa dhe Marketing nga *Rutgers University*. Siç u përmend më lart, GIZ ka sponsorizuar edhe praninë dhe punën e këshilltarit të Studimeve të Integuara, Prof. Norbert Marx.

#### SHPËRBLIMET E FITUARA PËR VEPRIMTARINË SHKENCORE

Universiteti nuk ka fituar ndonjë çmim të dukshëm për veprimtarinë shkencore, me përjashtim të dhënies së Urdhrit të Meritës nga Presidenti i Maqedonisë për kontributit akademik dhe komunitetit. Sukseset individuale akademike kanë qenë të shpërblyer dhe tre anëtarë të komunitetit të UEJL janë akademikë.

### FINANCIMI

#### MËNYRA E REALIZIMIT TË FINANCIMIT

Shumica e të ardhurave të UEJL-së buron nga tarifat e shkollimit të studentëve. Tarifat e shkollimit kanë qenë, dhe ka të ngjarë të mbeten në të ardhmen të afërta, prandaj burimi kryesor i të ardhurave për Universitetin të mbeten ato. Burime të tjera të të ardhurave kanë origjinën në veprimtaritë e shërbimeve të tjera të Universitetit (të trajnimit të kompanive të jashtme ose të projektimit të programeve të zhvillimit për bizneset). Së fundi, qeveria kohëve të fundit ka bërë një kontribut ndaj Universitetit. Ky financim ka qenë jashtëzakonisht i dobishëm në ruajtjen dhe sigurimin e arsimit të cilësisë së lartë në UEJL. Duhet theksuar se toka në të cilën është ndërtuar kampusi në Tetovë nuk i përket Universitetit ose Fondacionit, por e qeverisë dhe është marrë për shfrytëzim në bazë të një marrëveshje afatgjatë.

Mënyra e realizimit të financimit është si vijon: tarifat e shkollimit - 87.40%, të ardhurat komerciale - 1.44%, aktivitetet financiare - 1.43%, projektet - 0.25% dhe subvencione shtetërore janë pjesa e mbetur 9.48%.

Siç mund të shihet, ekziston një mbështetje e lartë në tarifën e shkollimit të studentëve, duke i dhënë ekspozimin financiar Universitetit ndryshimeve demografike apo rekrutimit të numrit të studentëve. Është e dëshirueshme për të identifikuar dhe ndjekur burime shtesë të të ardhurave dhe të diversifikohen rrjedhat e të ardhurave.

#### *Pjesa e asetëve nga buxheti në totalin e asetëve*

Sipas të dhënave më të fundit, asetet e përgjithshme të Universitetit janë 1,304,951,000 MKD. Për vitin fiskal 2015, të ardhurat nga shkollimi dhe donacionet nga bursat janë 261,677,000 MKD. Të ardhurat e përgjithshme për këtë vit ishin 550,856,000 MKD.

### PËRQINDJA E PAGESËS SË SHKOLLIMIT TË STUDENTËVE NË ASETET E PËRGJITHSHME

Sipas numrave pjesa e pagesës së shkollimit të studentëve në totalin e asetëve është 20.052%.

### PAGESA E SHKOLLIMIT

Siç u përmend më sipër, pagesë shkollimi përbën 87.40% të financimit, dhe në vitin 2015 arritën në 261,677,000 MKD.

### PËRFUDNIMI DHE REKOMANDIMET PËR PJESËN INSTITUCIONALE

#### PËRFUDNIMI

Siç mund të shihet në raport, Universiteti i Evropës Juglindore zë një pozitë të çmuar në mjedisin e arsimit të lartë të Republikës së Maqedonisë dhe në zonën e Ballkanit në përgjithësi. Ai është pa diskutim Universiteti më i suksesshëm që ka për qëllim të ofrojë arsimim cilësor pavarësisht përkatësisë etnike, gjuhës amtare, fesë, gjinisë, apo bindjeve politike të studentëve. Ka prodhuar mbi 10.000 të diplomuar individualë, të cilët janë dëshmi pozitive për vazhdimin e vlefshmërisë së misionit dhe vizionit të themelimit të Universitetit.

Universiteti duhet, megjithatë të pranojë se po përballlet me një pamje të ndryshuar dhe që po ndryshon në arsimin e lartë. Gjendja e keqe e vazhdueshme e ndikimeve të ekonomisë globale ndikon tek të gjithë në arsim, përfshirë UEJL; rënia demografike ka reduktuar numrin e studentëve nga të cilat ne mund të rekrutojmë; konkurrenca e vazhdueshme që zgjerohet nga institucionet e tjera të cilat bëjnë rekrutimin e studentëve e bën arsimin më të vështirë dhe ai shkon e bëhet arenë e mbipopulluar e arsimit të lartë, duke disavantazuar ato institucione që janë subjekte të vetëfinancimit.

Megjithatë, UEJL ka përparësi që duhet ta mundësojë atë për të vazhduar përmbushjen e vizionit dhe misionit të tij gjatë gjithë periudhës së Planit strategjik të ardhshëm: UEJL ka një reputacion rajonal për përsosmëri; siguron një fokus të veçantë në shumëgjuhësi dhe multikulturalizëm në të dy kampuset, përvojë dhe dizajnim

të kurrikulave; ofron mësimdhënie inovative në disa programe në gjuhën angleze, gjë e cila është vendimtare për tregun aktual të punësimit; ka staf shumë profesional dhe të aftë akademik dhe administrativ dhe, ndoshta, më e rëndësishmja, Universiteti ka ndërtuar një besnikëri në mesin e personelit, studentëve, dhe alumni drejt vizionit të arsimit të lartë që miraton përditësime - një arsim terciar gjithëpërfshirës, ndërkombëtar dhe të cilësisë së lartë në dispozicion për të gjithë në bazë të meritës dhe dëshirës.

## REKOMANDIMET PËR PËRMIRËSIM

Rekomandimet e mëposhtme rrjedhin nga ky raport, dhe janë riprodhuar këtu për lehtësi referimi. Ato nuk janë vendosur sipas rendit.

- Rishqyrtoni miratimin për përdorimin e formatit më të hershëm të Raportit të vetëvlërësimit dhe formularin;
- Krijoni marrëdhënie dhe marrëveshje efektive, praktike dhe ndërkombëtare të zbatueshme;
- Rritni regjistrimin e studentëve duke ruajtur diversitetin gjuhësor dhe etnik të trupit studentor të Universitetit;
- Diversifikoni rrjedhat e të ardhurave, për të reduktuar varësinë nga pagesat e shkollimit nga studentët dhe kontributin e shtetit;
- Ndërtoni, ruani dhe verifikoni aplikimin e shkathtësive të përfshira në kurrikula në tregun e punës;
- Zhvilloni, thelloni dhe përmirësoni përdorimin e teknologjisë në klasë (klasat fizike dhe digjitale);
- Tentoni të bashkërendoni punën praktike të detyrueshme me dizajnimin e kurrikulave, me qëllim që të përmirësoni aplikimin dhe koherencën e punës praktike me rezultatet e synuara nga programet;
- Rritni përfaqësimin dhe pjesëmarrjen e studentëve në takimet e këshillave të fakulteteve dhe takimet e ekipeve të cilësisë;
- Vendosni një numër të vogël të kompjuterëve në bibliotekë me qasje të kontrolluar që kanë abonim në disa baza të të dhënave të hulumtimit;
- Krijoni një politikë të detyrueshme të Universitetit për krijimin dhe njohjen e marrëveshjeve të të mësuarit ka të bëjë me mobilitetin, si hyrës dhe dalës;
- Riaktivizoni asociacionin e aluminit dhe stimuloni alumnin për t'u bashkuar, duke përfshirë një rol më aktiv dhe të formalizuar në vendimet e vazhdueshme operationale (si, për shembull, një ose dy vende në Senatin e Universitetit të rezervuara për përfaqësuesit e zgjedhur të Alumnit);
- Rishikoni dhe uniformoni mbështetjen financiare të barabartë për hulumtimin dhe bëni atë variabile, rigoroze dhe të bazuar në rezultate (ndoshta duke caktuar buxhet qendror për hulumtim për Zyrën e hulumtimit për mbështetje të publikimit, në të cilën anëtarët e stafit do të aplikojnë për asistencë për publikim të librave, teksteve universitare ose revistave; dhe të delegoni një pjesë të buxhetit të hulumtimit tek dekanët — me ose pa mbikëqyrje nga Prorektori për hulumtim — të cilët do të jenë në gjendje të alokojnë mbështetje më të madhe për pjesëmarrje në konferencë për hulumtuesit

produktivë dhe më pak për hulumtuesit joproduktivë ose ata që marrin pjesë vetëm në konferencat jofiduese ‘konferenca me pushime’);

- Zhvilloni një burim qendror ose specifik për fakultetet për identifikim dhe angazhim të ‘mësimdhënësve klinikë’ me qëllim që të mbështesë stafin mësimdhënës për të përmbushur obligimet e tyre në këtë aspekt;
- Merrni në konsideratë krijimin e një fondi të vogël të zhvillimit profesional në dispozicion (sipas aplikimit dhe dëshmive) për stafin administrativ;
- Zhvilloni objektiva përmirësuese më të sakta dhe efektive për stafin individual dhe menaxherët, bazuar në të dhënat (si p.sh. vlerësimi nga studentët, vëzhgimi i mësimdhënies, rezultatet nga hulumtimi, rishikimet e mëparshme të performancës dhe objektivat, rezultatet nga.);
- Mbështetni ofrimin e aktiviteteve të Parlamentit studentor edhe për studentët në Shkup;
- Kërkoni që i gjithë stafi, fakultetet, dekanatet dhe qendrat të njoftojnë Zyrën e hulumtimit dhe Institutin Max Van der Stoel për projektet që kanë aplikuar, fituar ose realizuar dhe përfunduar.